

20181643008

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR THEMELIM TË AGJENCISË PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 1

Në Ligjin për themelim të Agjencisë për Përkrahje Financiare në Bujqësinë dhe Zhvillim Rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 72/2007, 5/2009, 43/14, 193/15 dhe 39/16), neni 11 ndryshohet si vijon:

Me Agjencinë udhëheq drejtori.

Drejtori i agjencisë ka zëvendës.

Drejtorin dhe zëvendës drejtorin e Agjencisë i emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Për emërim të drejtorit dhe zëvendës drejtorit shpallet konkurs publik në tri gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë prej të cilave një nga gazetatat që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Drejtor mund të emërohet personi i cili i plotëson kushtet si vijojnë:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) ka marrë së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallën VII/1 të përfunduar;
- 4) ka së paku pesë vjet përvojë pune;
- 5) posedon një nga certifikatat ose dëshmitë ndërkombëtarisht të pranuar si në vijim, për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

- TOEFEL IBT së paku 74 pikë,

- IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë,

- ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),

- FCE (FCE) (Cambridge English: First) – të dhënë,

- BULLATS (BULATS) - së paku 60 pikë ose

- APTIS (APTIS) - së paku niveli B2 (B2).

Zëvendës drejtor mund të emërohet personi i cili i plotëson kushtet e shënuara në paragrafin 5 të këtij neni.

Emërimi i drejtorit dhe zëvendës drejtorit bëhet në bazë të profesionalizmit dhe kompetencës së tij.

Mandati i drejtorit dhe i zëvendës drejtorit zgjat katër vjet."

Neni 2

Në nenin 12 paragrafi 3 pas fjalës: "të" shtohen fjalët: "zëvendës drejtorit dhe".

Pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri 4 si vijon:

"Në rast kur drejtori i Agjencisë mungon ose kur për shkak të sëmundjes dhe shkaqeve tjera nuk ka mundësi ta ushtrojë funksionin e vet e zëvendëson zëvendës drejtorin në kuadër të autorizimeve të dhëna nga drejtori i Agjencisë."

Neni 3

Në nenin 14 paragrafi 1 ndryshohet si vijon:

"Drejtori dhe zëvendës drejtorin i Agjencisë për punën e vet përgjigjen para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e në lidhje me shfrytëzimin e mjeteve nga ndihma paraaderuese e Bashkimit Evropian janë përgjegjës edhe para Koordinatorit nacional për autorizim."

Neni 4

Në nenin 15 në fjalinë hyrëse pas fjalës "Drejtori" shtohen fjalët: "dhe zëvendës drejtori".

Neni 5

Dispozitat nga nenin 1 të cilat kanë të bëjnë me plotësimin e kushtit për posedim të certifikatave ose dëshmive ndërkombëtarisht të pranuar për njohje aktive të gjuhës angleze nuk do të zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 31 dhjetor 2018.

Neni 6

Drejtori dhe zëvendës drejtori i cili është i emëruar në periudhën nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 31 dhjetor 2018, është i obliguar ta plotësojë kushtin për njohje të gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit të tij.

Drejtorit dhe zëvendës drejtorit i cili nuk do t'i plotësojë kushtet për njohje të gjuhës së huaj në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, i ndërpritet mandati.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".